



100 Vjet Pavarësi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2061, datë 14.06.2012

për

**“Caktimin e Kodit të Pikës Ndërkombëtare të Sinjalizimit (ISPC)
sipërmarrësit “NISATEL ” Sh.p.k.”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj.M.Drushku, në mbledhjen e datës 14.06.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

- **Për Caktimin e Kodit të Pikës Ndërkombëtare të Sinjalizimit (ISPC) sipërmarrësit “NISATEL” Sh.p.k.**

BAZA LIGJORE:

- Ligj nr. 8485 datë 12.05.1999, “Kodi i Proçedurave Administrative” (**KprA**);
- Shkronja “j”, e nenit 8, nenet 80 deri 90 të ligjit 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);
- Akti normativ rregullator Nr. 17, datë 16. 04. 2010 “Rregullat për Administrimin e Kodeve të Pikave të Sinjalizimit Kombëtare dhe Ndërkombëtare(NSPC dhe ISPC)” (**Rregullorja**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1257, datë 16.04.2010;

- Pika 17 e nenit 21 të “*Rregullores së Brendshme të AKEP*”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar (*Rregullorja e Brendshme*);

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Dokumentacioni shkresor i sipërmarrësit “NISATEL” Sh.p.k., sipas të cilave ka aplikuar për Kodin e Pikës Ndërkombëtare të Sinjalizimit (ISPC);
2. Relacioni shpjegues mbi Projekt-Aktin (*Relacion*);
3. Projekt-akti për “Caktimin e Kodit të Pikës Ndërkombëtare të Sinjalizimit (ISPC) sipërmarrësit “NISATEL” Sh.p.k, (*Projektvendimi*);

si dhe,

duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Sipërmarrësi “NISATEL” Sh.p.k., është regjistruar në Regjistrin e Sipërmarrësve të AKEP (numër certifikate: 2012-AP-U62-8-3, datë 26.03.2012) për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike si më poshtë:

A. Rrjete publike të komunikimeve elektronike:

1. Rrjete publike tokësore fikse.

B. Shërbime publike të komunikimeve elektronike:

1. Shërbime telefonike,
2. Shërbimet e linjave me qira,
3. Shërbime të tjera të komunikimeve elektronike,

dhe ka aplikuar në AKEP sipas Rregullores për caktimin e Kodit të Pikës Ndërkombëtare të Sinjalizimit (ISPC).

2. Në dokumentacionin e depozituar në AKEP, në aplikimin për caktimin e Pikës Ndërkombëtare të Sinjalizimit (ISPC) nga sipërmarrësi “NISATEL” Sh.p.k., bëjnë pjesë:
 - a) Formulari i Aplikimi për Caktim e Kodit të Pikës Ndërkombëtare të Sinjalizimit (ISPC);
 - b) Marrëveshja me operatorin ndërkombëtar të pikës së sinjalizimit në distancë, që përdor teknologjinë TDM bazuar në Sistemin e Sinjalizimit ITU-T Nr.7 (SS NR.7), në të cilën nuk janë bërë ende pjesë rezultatet e testeve, sipas paragrafit “*Test Procedures*” të kësaj Marrëveshje;
 - c) Dokumenta plotësuese, kërkuar sipërmarrësit nga AKEP-i sipas pikës 5.3.a) të Rregullores;
3. Drejtoria e Rregullimit Teknik si struktura vlerësuese e aplikimit çmon se:

a) Formulari i Aplikimit:

Formulari i Aplikimit për Caktimin e Kodit të Pikës Ndërkombëtare të Sinjalizimit (ISPC), i depozituar nga sipërmarrësi “NISATEL” Sh.p.k. me shkresën Nr.534/3 Prot. AKEP, datë 28.05.2012, është plotësuar në përputhje me rregulloren “Për Administrimin e Kodeve të Pikave të Sinjalizimit Kombëtare (NSPC) dhe Ndërkombëtare (ISPC)”.

b) Marrëveshja me operatorin ndërkombëtar që përdor teknologjinë TDM bazuar në Sistemin e Sinjalizimit ITU-T Nr.7 (SS NR.7):

- i. Me shkresën përcjellëse Nr.534 Prot.AKEP, datë 21.03.2012 si dhe dokumentave plotësues, sipas kërkesës së AKEP, për plotësimin e kritereve të ndryshme të vlerësimit të aplikimit, në përputhje me pikën 5.3 të Rregullores, sipërmarrësi “NISATEL” Sh.p.k. ka depozituar në AKEP marrëveshjen origjinale midis “NISATEL” Sh.p.k. dhe “Trans World Telecommunication” (TWT) S.p.a.
- ii. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga sipërmarrësi “NISATEL” Sh.p.k., sipas Rregullores ai i plotëson kushtet teknike për të marrë në përdorim Kodin e Pikës Ndërkombëtare të Sinjalizimit (ISPC).
- iii. Sipërmarrësi, sipas paragrafit “*Test Procedures*” të Marrëveshjes në fjalë dhe Rekomandimeve përkatëse të ITU-së, brënda një afati kohor të caktuar nga AKEP-i, duhet të kryejë testet e përcaktuara me qëllim që sipas pikës 6.3 të Rregullores të vërtetojë se do të vendosi në shërbim një pikë sinjalizimi efektive, që ka të paktën një Message Transfer Part (MTP) që sinjalizon lidhjen në rrjetin ndërkombëtar të sinjalizimit.

P Ë R K Ë T Ë A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë që aplikimi i sipërmarrësit “NISATEL” Sh.p.k. është në përputhje me procedurën e përcaktuar Aktin nr. 17, datë 16. 04. 2010 “*Rregullat për Administrimin e Kodeve të Pikave të Sinjalizimit Kombëtare dhe Ndërkombëtare(NSPC dhe ISPC)*”, bazuar në KprA, shkronjën “j”, të nenit 8, nenet 80 deri 90, pikën 1 të nenin 114 dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit 9918, si dhe pikën 17 të nenit 21 të *Rregullores së Brendshme të AKEP*, me qëllim dhënien e mundësisë sipërmarrësit për të kryer testet e nevojshme cituar sa më sipër,

V E N D O S:

1. T’i caktojë sipërmarrësit “NISATEL” Sh.p.k. Kodin e Pikës Ndërkombëtare të Sinjalizimit (ISPC), sipas *Aneksit I*, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Afati kohor për kryerjen e testeve të përcaktuara në Marrëveshjen me operatorin ndërkombëtar (“Trans World Telecommunication” (TWT) S.p.a.) të pikës së sinjalizimit në distancë, që përdor teknologjinë TDM bazuar në Sistemin e Sinjalizimit ITU-T Nr.7 (SS NR.7), është një muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Mosplotësimi i këtij kushti nga sipërmarrësi e bën këtë vendim të pavlefshëm.
3. Sipërmarrësi “NISATEL” Sh.p.k. duhet të depozitojë në AKEP brenda afatit të caktuar të për vënien në punë të këtij kodi, rezultatet e testeve të kryera duke e bërë pjesë (Aneks) të marrëveshjes me operatorin në distance Slovak Telekom AS, sipas pikës 6, “ Formulari i Aplikimit” të Rregullores;

4. AKEP-i do të anullojë caktimin Kodit të Pikës Ndërkombëtare të Sinjalizimit sipas këtij vendimi, në se ky kod nuk është vendosur në shërbim nga sipërmarrësi sipas afatit të përcaktuar në pikën 6.5 si dhe të rasteve të tjera të parashikuara në Aktin nr. 17, datë 16. 04. 2010 “Rregullat për Administrimin e Kodeve të Pikave të Sinjalizimit Kombëtare dhe Ndërkombëtare(NSPC dhe ISPC)”.
5. Ky vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. Alban **KARAPICI** _____
2. Alketa **MUKAVELATI** _____
3. Benon **PALOKA** _____
4. Zamira **NURÇE** _____

Aneksi: 1

Caktim i Kodit të Pikës Ndërkombëtare të Sinjalizimit (ISPC):

Sipërmarrësit “NISATEL” Sh.p.k., i caktohet për përdorim Kodi i Pikës Ndërkombëtare të Sinjalizimit (ISPC) si më poshtë:

1. Vlera numerike e ISPC (National Signalling Point Code) sipas formatit binary to decimal (3-8-3):

Kodi i Pikës Ndërkombëtare të Sinjalizimit(ISPC)	Sipërmarrësi	Emri i Pikës Sinjalizimit
<i>3-233-4</i>	<i>NISATEL</i>	<i>CT Nisatel Tirana</i>

2. Kodi i treguesit të Rrjetit NI=00(binar).
3. Implementimi dhe përdorimi i këtij kodi të bëhet në formatin binar 3-8-3 (14 bit) dhe në përputhje me “Rregullat për Administrimin e Kodeve të Pikave të Sinjalizimit Kombëtare dhe Ndërkombëtare” (VKD Nr.1257, datë 16.04.2010 i AKEP) dhe Rekomandimit Q.708 të ITU-T.

=====